



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 490/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë administrimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.490/2019 e datës 17.11.2019, e paraqitur nga Koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), me të cilën ka kërkuar që një fletëvotim në Vendvotimin 1109b/04R, të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ - QNR, që këtë fletëvotim ta largoj nga votat e vlefshme të publikuar me rezultatin përfundimtar të datës 07.11.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 17.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.490/2019, nga subjektit politik, koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 16.11.2019, gjatë ndërrimit të dytë të punës (nga ora 20:24:00-), në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë numërimit të votave në kutinë e votimit 1109b/04R, një fletëvotim në të cilin përveç se është votuar për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), votuesi në rubrikën 112 dhe 113 ka shkruar fjalë fyese dhe ofenduese, të tilla si “Robt ja u .... krejt jeni hajna”, dhe ky fletëvotim është shpallur i vlefshëm, e që sipas ankuesit një veprim i tillë bie në kundërshtim me Kodin e Etikës për Zgjedhje dhe mostrën 7 të Doracakut të KQZ-së, duke kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm dhe të obligohet KQZ-QNR, që këtë fletëvotim ta largoj nga votat e vlefshme dhe rezultati përfundimtar.

Lidhur me pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ankesës i ka bashkangjitur një mostër të fletëvotimit të pavlefshëm sipas Doracakut të KQZ-së, shtojca 8 dhe 7 dhe një kopje të fletëvotimit nga kutia e votimit nr.1109b/04R, në cilësi të provave materiale.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga shkresat e lëndës konstatohet se në Vendvotimin 1109b/04R, gjatë procesit të rinumërimit, është shpallur nga ana e QNR-së, 1 fletëvotim i vlefshëm, në të cilin votuesi përveç se ka votuar për subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i njëjti në rubrikën 112 dhe 113 ka shkruar fjalë fyese dhe ofenduese.

Ankuesi ka paraqitur pretendimin se në kuptim të nenit 4 lidhur me ndryshimin e nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, dhe nenit 8 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, ku ka kërkuar nga PZAP-i, që ky fletëvotim të shpallet i pavlefshëm sepse bie në kundërshtim me Kodin e Etikës për Zgjedhje dhe mostrën 7, të Doracakut të KQZ-së.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës, ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, Paneli ka gjetur se nuk qëndron pretendimi i ankuesit se pa të drejtë një fletëvotim i gjetur në Vendvotimin 1109b/04R, është shpallur i vlefshëm, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk e përmbush asnjërin kriter të pa vlefshmërisë, pasi që shihet qartë qëllimi i votuesit pa marrë parasysh që në fletëvotimin në fjalë ekziston edhe një shkrim me gjuhë ofenduese nga votuesi, por nuk janë prekur rubrikat e subjekteve tjera politike, përveç të atij subjekti politik që votuesi ka pas për qëllim të votoi, dhe kjo është në pajtim me mostrën kur konsiderohen të vlefshme fletëvotimet, mostra nr.5, të Doracakut të KQZ-së, andaj i njëjti duhet të llogaritet i vlefshëm dhe me të drejtë i njëjti fletëvotim është vlerësuar i vlefshëm gjatë administrimit në QNR.

Nga sa u tha më sipër e në kuptim të nenit 117 dhe nenit 118.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 490/2019 më datë 18.11.2019**

**Kryesues i Panelit  
Fejzullah Rexhepi**



**Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.**